



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.310, datë 21.11.2022

PËR

**“MIRATIMIN E LISTËS SË KANDIDATËVE PËR DREJTUES NË  
PROKURORINË E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË  
ORGANIZUAR TË CILËT PLOTËSOJNË KUSHTET E KANDIDIMIT”**

Bazuar në nenet 149/a dhe 148/dh pika 3 të Kushtetutës, nenin 15 pika 1 të ligjit Nr.95/2016 *"Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"*, nenin 52 pika 5 dhe 7 të ligjit Nr.96/2016 *"Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa "a" të ligjit Nr.115/2016 *"Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"* i ndryshuar, si dhe nenin 18 të Rregullores *"Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar"* e ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës me emrat e tre kandidatëve për vendin vakant të drejtuesit në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, të cilët plotësojnë kushtet paraprake të kandidimit për ngritjen në detyrën e drejtuesit, në rend alfabetik si më poshtë:
  - Adnand Xholi
  - Altin Dumani
  - Edvin Kondilli
2. Relacioni shoqërues është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Kandidatët e listuar në pikën 1 të këtij vendimi, do të vazhdojnë garën e mëtejshme për vendin vakant të drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
4. Të njoftohen për këtë vendim të gjithë kandidatët.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet ne faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 21.11.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR  
Alfred Balla

ZV/KRYETAR  
Tartar Bazaj





**ANËTAR**  
**Sokol Stojani**

**ANËTAR**  
**Bujar Sheshi**

**ANËTAR**  
**Nurihan Seiti**

**ANËTAR**  
**Eloida Goxhi**

**ANËTAR**  
**Esmeralda Keshi**

**ANËTAR**  
**Zeqir Hoda**

**ANËTAR**  
**Mirela Bogdani**

**ANËTAR**  
**Arta Mandro**

**ANËTAR**  
**Ledina Riza**